



VENDIM

Nr. 14, Datë 18.11.2013

**PËR MIRATIMIN E NGARKESËS MËSIMORE TË NORMUAR VJETORE PËR PERSONELIN
AKADEMIK TË ANGAZHUAR NË FUNKSIONE ADMINISTRATIVE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Senati i Universitetit të Arteve në mbledhjen e datës 18.11.2013, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe pas diskutimeve të anëtarëve, bazuar në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar si dhe në Statutin e Universitetit të Arteve e Udhëzimin nr. 20, datë 09.05.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës,

VENDOSI

1. Ngarkesa mësimore e normuar vjetore për personelin akademik të UART, të angazhuar në funksione administrative në Universitetin e Arteve do të jetë 150 orë mësimore.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE